



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:144250

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05590995

**P.nr.506/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit S.M. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 paragrafi 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tutje: KPPK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.202/21 të datës 05.07.2021, të plotësuar dhe ndryshuar me parashtrësën e datës 16.03.2022, duke vendosur sipas kërkesës për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 18.04.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.202/21 të datës 05.07.2021, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPPK), jep:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

I akuzuari:

S.M. , nga i ati M., e ëma Ll., e vajzërisë K. i lindur me datë ... në Mitrovicë, ku edhe jeton në rrugën “Mbreti Pjetër i Parë” nr....” Komuna e Mitrovicës, profesor, i martuar, ka të kryer shkollën e lartë, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ....

### **ËSHTË FAJTOR**

SEPSE:

Që nga 1999 e tutje në Mitrovicë në rrugën “S.”, jashtëligjshëm e ka uzurpuar pronën e pa luajtshme të dëmtuarit XH.V., në atë mënyrë që në periudhën e cekur e shfrytëzon lokalit të cilin, në bazë të dokumentacionit i dëmtuari e ka fituar nga komuna me datën 10.11.1988, dhe atë lokal e shfrytëzon si punëtori të këpucëtarisë, të cilin lokal e shfrytëzon pa asnjë kompensim.

**Me këtë ka kryer veprën penale Uzurpimi i kundërligjshëm i pronës nga neni 259 paragrafi 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 259 të KPRK-së, si dhe nenit 364,449,452,462,493 dhe 495 të KPP-së e:

## G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300 euro (*me fjalë: treqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që t' a paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 39 të KPPK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 15 (pesëmbëdhjetë) euro gjobë të papaguar.
- II. Obligohet i pandehuri që ta liroj pronën – lokalin e të dëmtuarit XH.V., e cila gjendet ne rrugën “ S.” nr.. në Mitrovicë, me numër të parcelës .. dhe .., me sipërfaqe prej 24.5 m2, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 20 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. I dëmtuari, XH.V., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.202/21 të datës 05.07.2021, kundër të pandehurit S.M., për shkak të veprës penale Uzurpimi i kundërligjshëm i pronës nga neni 259 par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga Gjykata ka kërkuar dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPP-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale Uzurpimi i kundërligjshëm i pronës nga neni 259 par.1 të KPRK-së, me të cilën akuzohet i pandehuri ligjvënësi ka parashikuar dënohet me gjobë apo me burgim deri në një (1) vit, që nënkupton se

në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: Vendimi i Ministrisë së Punës nr... i datës 08.09.1994, Certifikata e RUJP e Komunës së Mitrovicës nr. ... ta datës 13.10.1994, Vendim i Departamentit të Ekonomisë të Komunës së Mitrovicës UP.nr.332/95 i datës 21.09.1994, ku u regjistrua në Regjistrin e veprimeve: Marrëveshja për dhënie të tokës ndërtimore në përdorim të përkohshëm nga viti 1988 nga SIZ-i i veprimeve komunale, e cila u vazhdua me vendimin nr... i datës 04.06.1996 deri me 27.05.1998, Konfirmim nga Elektro Kosmet për shlyerjen e obligimeve e datës 15.09.1994, Marrëveshja për rimbursimin e shpenzimeve të tokës ndërtimore të Fondit Zhvillimor dhe pronarit të objektit XH.V. i datës 10.02.1992, Vendimi i Departamentit të Urbanistikës së Komunës së Mitrovicës mbi plotësimin e kushteve për ndërtim dyqan Rr. “ Sutjeska” nr...në emër të XH.V. nr... e datës 20.09.1994, Vërtetim RUJP i datës 15.08.1994 për ndryshimin e qëllimit të objektit, një kopje e planit – një skicë e vendit ku ndodhet ambienti me qëllim legalizimin e zgjerimin, Vendim për plotësimin e kushteve teknike për kryerjen e veprimtarive e datës 06.09.1994, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit i datës 05.05.2021, Procesverbali i marrjes në pyetje të djalit të dëmtuarit i datës 16.03.2022 dhe shkresat tjera të lëndës janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprën penale Uzurpimi i kundërligjshëm i pronës nga neni 259 par.1 të KPK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në përputhje me nenin 69 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoi të gjitha rrethanat në matjen e dënimit, ashtu që Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që një nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprime të paligjshme.

Gjykata si në dispozitiv të Aktgjykimit, të pandehurin e ka obliguar që ta lirojë pronën, duke qenë se nga shkresat e lëndës rezulton se ajo pronë nuk është e tij dhe se nuk ka ndonjë bazë juridike mbi të cilën e ka shfrytëzuar. Ndërsa nga provat që gjenden në lëndë, rrjedh se drejtën e pronësisë e ka pala e dëmtuar në këtë rast.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike që ka të bëjë me kompensimin e fitimit të humbur. Kjo

nga fakti se të dhënat që gjenden në aktakuzë, nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin e plotë edhe sa i përket kërkesës pasurore juridike në këtë drejtim dhe se gjykata nuk mund që ta aprovoj kërkesën pasurore juridike duke u mbështetur vetëm në pretendimin e palës së dëmtuar, pa një mendim dhe konstatim më të bazuar, andaj gjykata të dëmtuarin e ka udhëzuar që kërkesën pasurore juridike mund ta realizon në kontestin civil juridik në mbështetje të nenit 462 të KPP-së, sa i përket pretendimeve për kompensimin e fitimit të humbur.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.506/2021, datë 18.04.2024**

Gjyqtari

---

Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.